



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 shtator 2024  
Nr. Ref.: RK 2528/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI77/23**

Parashtrues

**Interlex Associates sh. p. k.**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit AC-I-23-0083-A0001 të 16 marsit  
2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të  
Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Interlex Associates sh.p.k., me seli në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC-I-23-0083-A0001] të 16 marsit 2023 të Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit).
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 20 mars 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij, të garantuara me nenet: 24 [Barazia Para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës ], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 4 prill 2023, kërkesa u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 13 prill 2023, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin GJR. KI77/23 caktoi gjyqtarin Safet Hoxha, gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI77/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 25 prill 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, një kopje të kërkesës së parashtruesit iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.
10. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.

11. Më 4 shtator 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte lidhur kontrata mbi urdhrin me një numër të madh të ish-punëtorëve të ndërmarrjes shoqërore “PMN SHARR”, për t’i përfaqësuar ata pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likudimit i NSH “Sharr” (në tekstin e mëtejme: AKP), në lidhje me dëmshpërblimet financiare për shkak të sëmundjes profesionale të shkaktuar si rezultat i ekspozimit ndaj azbestit. Sipas këtyre kontratave, në rast të çdo dëmshpërblimi financiar, 80 përqind e shumës së përgjithshme i takon punëtorit dhe 20 përqind parashtruesit të kërkesës, në emër të përfaqësimit.
13. Më 28 shkurt 2011, Bordi i AKP-së vendosi që procedura e likuidimit të “PMN SHARR” të fillojë më 22 mars 2011. AKP-ja kishte nxjerrë vendime për dëmshpërblimin financiar të punëtorëve dhe kishte realizuar pagesat për afro 400 prej tyre, sipas kontratës mbi urdhrin.
14. Më 22 korrik, 5 gusht dhe 7 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga AKP-ja realizimin e pagesave edhe për 18 punëtorë të cilët kishin vdekur, sipas kontratave mbi urdhrin. Parashtruesi i kërkesës pretendoi se, në rastet kur punëtorët kishin vdekur, trashëgimtarët e tyre duhet të përmbushin detyrimet e mbetura nga trashëgimlënësi.
15. Më 21 dhjetor 2022, AKP/AL-ja iu përgjigj kërkesës së parashtruesit të kërkesës. Kjo e fundit theksoi se, për 18 punëtorë të cilët kishin vdekur, trashëgimtarët e tyre kishin sjellë aktvendimet e trashëgimisë dhe kishin njoftuar që nuk do të japin autorizim të ri për parashtruesin e kërkesës. Sipas nenit 171 të Ligjit nr. 03/L-007 për Procedurën jokontestimore, në mënyrë që palët të kenë të drejtë për të pranuar pagesat duhet të kenë aktvendim mbi trashëgiminë dhe rrjedhimisht parashtruesi i kërkesës duhej të kishte prokurë nga trashëgimtarët në mënyrë që të pranonte pagesat. Në të kundërtën, pagesat do të realizoheshin direkt për palët trashëguese. AKP-ja po ashtu arsyetoi se sipas nenit 95 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), kur palët nuk jetojnë më shuhen edhe prokurat që i kanë dhënë.
16. Më 30 dhjetor 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me agjencinë kosovare të privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), kundër këtij njoftimit të AKP-së. Nëpërmjet kërkesëpadsisë, parashtruesi i kërkesës kërkoi që të miratohej edhe masa e përkohshme e sigurimit ndaj vendimit të AKP-së dhe të lejohej shpërndarja e pagesës në llogarinë e parashtruesit të kërkesës, në vlerën prej 20% nga vlera e përgjithshme e kompensimit për këta 18 punëtorë. Ai pretendonte se, në kohën e marrjes së vendimeve për kërkesat e punëtorëve, të gjithë ata ishin gjallë dhe se ishin pajtuar me vlerën e kompensimit dhe të përfaqësimit. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se ekzistonte rreziku që trashëgimtarët e punëtorëve të lartcekur t’i shpenzonin mjetet financiare të pranuar nga AKP-ja, dhe të pamundësohej realizimi i pagesave të përfaqësimit për punëtorët e lartcekur, në llogari të parashtruesit të kërkesës. Sipas tij, kjo mund të shkaktonte dëme të pariparueshme për të.
17. Më 17 janar 2023, e paditura kishte parashtruar përgjigjen e saj në DHPGJS, në lidhje me propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Sipas të paditurës, parashtruesi i kërkesës do të mund të pranonte pagesat vetëm në rastet kur trashëgimtarët e punëtorëve do t’i jepnin atij autorizimin e vlefshëm.

18. Më 1 shkurt 2023, DHPGJS-ja nëpërmjet Aktvendimit [C-III-22-0448] e refuzoi si të pabazuar propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurimit. DHPGJS-ja arsyetoi se, në rastet kur parashtruesi i kërkesës i kishte deponuar autorizimet e punëtorëve në AKP, kjo e fundit i kishte realizuar të gjitha pagesat e dëmshpërblimeve financiare në llogarinë bankare të parashtruesit të kërkesës. Ndërkaq, për punëtorët të cilët kishin vdekur dhe ishin lajmëruar trashëgimtarët e tyre, parashtruesi i kërkesës duhej të kishte autorizime nga këta të fundit në mënyrë që të realizoheshin pagesat nga AKP-ja, sepse sipas nenit 95, paragrafi 1 i LPK-së, në rastin kur pala vdes shuhet edhe prokura. DHPGJS-ja theksoi se, parashtruesi i kërkesës duhej të drejtonte pretendimet e tij për mospërbushje të detyrimeve nga kontratat tek trashëgimtarët e punëtorëve të vdekur sepse AKP-ja nuk është palë në këto kontrata.
19. Më 10 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Kolegjin e Apelit, kundër aktvendimit të DHPGJS-së, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Parashtruesi i kërkesës kërkoi që të anulohet aktvendimi i lartcekur, të caktohet masa e përkohshme e sigurimit dhe të lejohej pagesa e mjeteve të kërkuara.
20. Më 16 mars 2023, Kolegji i Apelit nëpërmjet Aktvendimit [AC-I-0083-A0001] e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës në lidhje me caktimin e masës së sigurisë. Kolegji i Apelit arsyetoi se parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar probabilitet të lartë mbi të drejtën që e pretendon dhe as që mund të ndodhë dëmi i pariparueshëm nëse nuk lëshohet masa e sigurisë. Kolegji i Apelit theksoi se kontrata mbi urdhrin ishte e lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe palëve të tjera, dhe rrjedhimisht AKP-ja nuk ishte palë në këtë çështje.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

*(i) Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së*

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, DHPGJS-ja dhe Kolegji i Apelit nuk i trajtuan pretendimet kryesore në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e ligjit duke mos dhënë përgjigje në çështjet kryesore. Parashtruesi i kërkesës thekson se ka mbetur pa përgjigje në lidhje me pretendimin kryesor, nëse AKP-ja është e obliguar të bëjë pagesën e dëmshpërblimit ndaj palëve të dëmtuara, të cilat po i mban pa bazë ligjore duke shkelur të drejtat pronësore. Sipas parashtruesit të kërkesës, vendimet e gjykatave të rregullta nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm. Parashtruesi i kërkesës thekson se ka pasur pritje legjitime që dispozitat ligjore do të zbatohen drejtë, pa arbitraritet dhe se do të realizonte të drejtën e tij.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta e kanë shkelur parimin e barazisë së armëve, për shkak se nuk e kishte pranuar asnjëherë kundërshtimin e AKP-së për caktimin e masës së sigurisë. Sipas parashtruesit të kërkesës, Kolegji i Apelit nuk i mori parasysh provat e paraqitura nga ai, si vendimet e AKP/AL-së, kontratat dhe autorizimet me palët, por është mbështetur vetëm në argumentet e palës kundërshtare.
23. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se, sipas nenit 4 të Ligjit nr.06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme, kërkesat në lidhje me procesin e privatizimit dhe kërkesat pronësore do të shqyrtohen dhe gjykojnë në shkallë të parë nga një Kolegji i specializuar, i përbërë nga 3 gjyqtarë, ndërsa në rastin e tij ka vendosur gjyqtarja individuale.

*(ii) Pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNj-së*

24. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: “Gjatë gjykimit në rastin konkret, parashtruesit të kërkesës i është pamundësuar të realizoj të drejta të pakontestueshme vetëm nga shkakun se DHPGJS nuk e ka trajtuar dhe nuk ka vepruar ashtu siç e detyrojnë dispozitat në fuqi lidhur me masat e përkohshme dhe ato të sigurisë. Gjykata në këtë rast i ka mohuar propozuesit të vetmin mjet dhe mbrojtje të interesit pronësor, madje vetëm përkohësisht, deri në vendimin përfundimtar lidhur me padinë. Parimi i sigurisë juridike është i mishëruar dhe zbatohet në të gjitha nenet e Konventës, rrjedhimisht edhe në raport me mbrojtjen e pronës. Parashtruesi i ka ofruar DHPGJS-së të gjitha dokumentet e nevojshme zyrtare të cilat as Gjykata e as kundër-propozuesi fare nuk i kanë kontestuar”.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: “DHPGJS në mënyrë arbitrare dhe duke shkelur të drejtat e palëve, në këtë rast të klientëve të mijë u ka mohuar atyre dhe vazhdon të ju mohoj brutalisht të drejtën e pronës, sepse që nga vendimi i bordit të drejtorëve të AKP-ës të qershorit 2022 pa asnjë bazë juridike dhe duke diskriminuar grupin prej 16 klientëve nuk ju ka bërë pagesën e dëmit për dallim nga 400 punëtorët e tjerë të cilët i kanë realizuar këto pagesa në vitin 2022, me çka atyre u ka mohuar të drejtën për mbrojtjen e të drejtës së pronës së garantuar me nenin 46, lidhur me nenin 21 të Kushtetutës së Kosovës”.

(iii) Pretendimet e tjera

26. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se aktvendimi i kontestuar ka shkelur nenin 21, 54 dhe 102 të Kushtetutës, sepse “një ankesë e vetme dhe ajo pa pasur mundësi të pjesëmarrjes në seancë konsiderojmë se nuk paraqet asnjë garanci të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të garantuara në kuptim të Kushtetutës së Kosovës”.

(iv) Kërkesa për masë të përkohshme

27. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata caktimin e masës së përkohshme, bazuar në nenin 13.7 të Kushtetutës, nenet 27 dhe 47 të Ligjit nr. 03L-121 për Gjykatën Kushtetuese, dhe rregullat 54 dhe 55 të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese.

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### Kushtetuta e Republikës së Kosovës

#### Neni 31

#### **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
[...]

#### Neni 46

#### **[Mbrojtja e Pronës]**

1. E drejta e pronës është e garantuar.  
[...]

### Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

#### Neni 6

#### **(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat

*dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]*  
[...]

#### **LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE**

##### **Neni 95**

*95.1 Me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe prokura të cilën ai e ka dhënë.*

[...]

#### **LIGJI Nr. 03/L-007 PËR PROCEDURËN JOKONTESTIMORE**

##### **Neni 171**

*171.1 Kur gjykata në procedurën trashëgimore konstaton se cilëve persona u takon e drejta për trashëgim, do t'i shpall këta persona trashëgimtarë me anë të aktvendimit të vet për trashëgim.*

[...]

#### **LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT**

##### **Neni 61**

##### **Masat e sigurimit**

*1. Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkesë/ padie.*

[...]

##### **Neni 74**

##### **Shqyrtimi i vendimeve të Autoritetit për likuidim**

[...]

*3. Në shkallë të parë, zhvillimi i lëndës apo procedurës lidhur me ankesa të tilla do t'i caktohet gjyqtarit të vetëm sipas rregullave të përcaktuara për shpërndarjen dhe caktimin e lëndëve.*

#### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

28. Gjukata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjukata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

##### **Neni 113**

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

*"1. Gjukata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.  
[...]

Neni 21

[Parimet e përgjithshme]

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë e personit juridik, ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
31. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49

[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht ...”.

32. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; ai konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-23-0083-A0001] e 16 marsit 2023, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
33. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 (2) (Kriteret e pranueshmërisë), të Rregullores së punës, që përcakton:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

34. Bazuar në praktikën e Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj apo vetëm në ndonjë pretendim specifik. Pretendimet qartazi të pabazuara në baza kushtetuese mund të kategorizohen në katër grupe: (i) pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime me “një mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e Gjykatës, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021; [KI21/21](#), parashtrues *Asllan Meka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021).

**(1) Pretendimet për shkëljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së**

35. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës konteston aktvendimin e Kolegjit të Apelit për refuzimin e masës së sigurisë. Pra, çështja në fjalë ka të bëjë me procedura paraprake dhe Gjykata do të vlerësojë nëse në rastin konkret është i aplikueshëm neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

*(i) Zbatueshmëria e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në lidhje me vendimin për refuzimin e masës së sigurisë*

36. Gjykata ripërsërit se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së zbatohet edhe në procedura paraprake, përfshirë masat e sigurisë, të cilat përcaktojnë të drejta ose detyrime civile në mënyrë efektive (shih rastet e Gjykatës, [KI195/20](#), parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafët 73-77; [KI75/21](#), parashtrues “*Abrazen LLC*”, “*Energy Development Group Kosova LLC*”, “*Alsi & Co. Kosovë LLC*” dhe “*Building Construction LLC*”, Aktgjykim i 19 janarit 2022, paragrafët 53-56). Bazuar në praktikën e GJEDNj-së, që të aplikohet neni 6 i KEDNj-së në procedurat paraprake, së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë “civile” si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë; dhe së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse (shih, rastin e GJEDNj-së, *Micallef kundër Maltës*, [nr.17056/06](#), Aktgjykim i 15 tetorit 2009, paragrafët 83-86).
37. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga AKP/AL-ja t’ia kompensojë 20 përqind nga vlera e përgjithshme e dëmshpërblimit financiar për 18 punëtorët me të cilët kishte nënshkruar kontrata mbi urdhrin në emër të përfaqësimit të tyre. AKP/AL-ja e refuzoi kërkesën e tij, me arsyetimin se punëtorët kishin vdekur dhe rrjedhimisht ishte shuar edhe prokura të cilën ia kishin dhënë parashtruesit të kërkesës; dhe kërkoi nga parashtruesi i kërkesës prokura të reja të nënshkruara nga trashëgimtarët e punëtorëve.
38. Parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesëpadi në DHPGJ-së përmes së cilës kërkoi që AKP/AL-ja t’ia transferojë mjetet financiare sipas kontratave që i kishte lidhur me punëtorët dhe deri në vendimin meritator të caktohej masa e sigurisë, në mënyrë që AKP/AL-ja të mos ekzekutojë mjetet financiare të trashëgimtarët e punëtorëve.
39. Gjykata vlerëson se, së pari, çështja në fjalë është e natyrës civile, e cila lidhet me kërkesën për dëmshpërblim financiar; dhe së dyti, do të mund të përcaktonte në mënyrë efektive të drejtat civile të parashtruesit të kërkesës. Gjykata konstaton se në rrethanat e rastit konkret është i aplikueshëm neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.



(ii) *Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor dhe "barazinë e armëve"*

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon që aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit mbi refuzimin e masës së sigurisë, ka shkelur të drejtën e tij për një proces të rregullt gjyqësor, përkitazi me "mosarsyetimin e vendimit gjyqësor" dhe "barazinë e armëve".
41. Në parim, garancitë e mishëruara në nenin 6, paragrafin 1 të KEDNj-së, përfshijnë edhe detyrimin e gjykatave që të paraqesin arsytim të mjaftueshëm për vendimet e tyre (shih rastin e GjEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë. Përkundër faktit që gjykata e brendshme ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe vendosjes për pranueshmërinë e dëshmimeve, ajo është e detyruar të justifikojë veprimet e saj duke arsyetuar të gjitha vendimet e saj (shih, rastet e GjEDNj-së: *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 24 korrikut 2003, paragrafi 36; si dhe rastin *Carmel Saliba kundër Maltës*, nr. 24221/13, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73).
42. Gjykata vëren se, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur një numër të madh të kontratave me ish-punëtorët e ndërmarrjes "PMN SHARR", për t'i përfaqësuar ata pranë AKP-së në lidhje me kërkesat për dëmshpërblimet financiare për dëmet e pësuar në punë, si rezultat i ekspozimit ndaj materialeve kancerogjene. Sipas kontratave mbi urdhrin të nënshkruar ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe punëtorëve, në rast të çdo dëmshpërblimi financiar, 80 përqind e shumës së përgjithshme i takon punëtorëve dhe 20 përqind parashtruesit të kërkesës, për shkak të përfaqësimit.
43. Gjykata vëren se, AKP-ja kishte vendosur në 400 raste të këtyre punëtorëve dhe kishte caktuar dëmshpërblime financiare, duke ia kompensuar parashtruesit të kërkesës 20 përqind nga vlera e përgjithshme për secilin punëtor, sipas kontratës mbi urdhrin dhe autorizimeve për përfaqësim. Një gjë e tillë nuk është kontestuese. Për 18 punëtorë të tjerë, AKP-ja kishte caktuar dëmshpërblime financiare, mirëpo nuk ia barti parashtruesit të kërkesës 20 përqind të shumës ashtu siç ishte përcaktuar me kontratat mbi urdhrin, me arsyetimin se këta punëtorë kishin vdekur dhe sipas nenit 95 të LPK-së ishin shuar prokurat e tyre. AKP-ja e njoftoi parashtruesin e kërkesës që sipas nenit 175 të LPK-së, duhej të sillte autorizime të reja nga trashëgimtarët e atyre punëtorëve, në të kundërtën mjetet financiare do të barteshin direkt te trashëgimtarët.
44. Parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesëpadi në DHPGJS me të cilën kërkoi që AKP -ja t'ia kompensojë 20 përqind nga vlera e përgjithshme e dëmshpërblimit financiar për 18 punëtorët me të cilët kishte lidhur kontrata mbi urdhrin në emër të përfaqësimit të tyre; dhe kërkoi caktimin e masës së sigurisë në mënyrë që AKP-ja të mos i bartë dëmshpërblimet financiare në llogari të trashëgimtarëve të punëtorëve të cilët kishin vdekur, deri në zgjidhjen e meritave të kërkesëpadisë.
45. DHPGJS-ja dhe Kolegji i Apelit vendosën për refuzimin e kërkesës për caktimin e masës së sigurisë ndaj njoftimit të AKP-së, me arsyetimin se sipas nenit 95 të LPK-së, me vdekjen e personit fizik shuhet edhe prokura të cilën e ka dhënë. DHPGJS-ja theksoi se 18 punëtorët kishin vdekur dhe rrjedhimisht ishte shuar prokura e tyre ndaj parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, kontesti ishte ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe trashëgimtarëve të punëtorëve dhe AKP-ja nuk ishte palë. Parashtruesi i kërkesës do të mund të drejtonte kërkesat e tij për mospërmbushje të detyrimeve nga kontratat mbi urdhrin tek trashëgimtarët e punëtorëve të vdekur dhe jo ndaj AKP-së. Edhe Kolegji i Apelit mbështeti arsyetimin e DHPGJS-së dhe vlerësoi që parashtruesi i kërkesës nuk kishte dëshmuar probabilitet të lartë mbi të drejtën që pretendon dhe as që mund të ndodhë dëmi i riparueshëm financiar nëse nuk lëshohet masa e sigurisë.

46. Gjykata thekson se DHPGJS dhe Kolegji i Apelit ofruan arsytetime të mjaftueshme në lidhje me refuzimin e masës së sigurisë. Gjykata nuk mund të zëvendësojë vlerësimet e tyre në lidhje me faktin nëse ishin përmbushur kriteret ligjore për caktimin e kësaj mase. Po ashtu, gjykatat e rregullta nuk vendosën në lidhje me meritat e kërkesëpadisë, nëse parashtruesi i kërkesës kishte të drejtë për kompensimet financiare të përcaktuara sipas kontratave mbi urdhrin.
47. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me mos arsyetimin e vendimit gjyqësor, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara.
48. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkeljen e parimit të barazisë së armëve, sepse gjykatat e rregullta nuk i morën parasysh provat e paraqitura nga ai por u mbështetën vetëm në ato të palës kundërshtare; dhe që nuk pranoi përgjigjet e palës së paditur.
49. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se AKP-ja ishte njoftuar për kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe kishte dorëzuar përgjigjet dhe kundërshtimet e saj. Të dy palët e përfshira në këtë proces gjyqësor patën mundësinë të përballëshin me pretendimet e njëra-tjetrës dhe të paraqisnin argumentet e tyre juridike.
50. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimi i DHPGJS-së ishte marrë nga një gjyqtar i vetëm, në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë se “*kërkesat në lidhje me procesin e privatizimit dhe kërkesa pronësore do të shqyrtohen dhe gjykojnë në shkallë të parë nga një Kolegj i specializuar, i përbërë nga tre (3) gjyqtarë*”. Gjykata vëren se vendimi në shkallë të parë ishte marrë nga një gjyqtar i vetëm dhe se Kolegji i Apelit nuk e kishte trajtuar fare këtë pretendim ankimor të parashtruesit të kërkesës në lidhje me përbërjen. Gjykata vëren se Ligji nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në nenin 74, përcakton se shqyrtimi i vendimeve të Autoritetit për likuidim, në shkallë të parë, zhvillimi i lëndës apo procedurës lidhur me ankesa do t'i caktohet gjyqtarit të vetëm.
51. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e parimit të “*barazisë së armëve*”, i përkasin pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara.

**(2) Pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNj-së**

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimet e gjykatave të rregullta mbi refuzimin e masës së sigurisë, shkelën të drejtat e tij pronësore duke mos ia njohur kompensimin financiar të përcaktuar sipas kontratave mbi urdhrin që i kishte nënshkruar me 18 punëtorët e lartcekur.
53. Gjykata rikujton se “prona” në kuptim të nenit 1 të Protokollit numër 1 të KEDNj-së përfshin pronën ekzistuese ose asetet, përfshirë edhe pretendimet në lidhje me të cilat personi ka së paku “pritje legjitime” që do t'i realizojë (shih, rastin e Gjykatës, [KI94/18](#), parashtrues Miodrag Seslija, Aktvendim për papranueshmëri i 10 prillit 2019, paragrafi 49; rasti i GJEDNj-së, *Presson Compania Naviera A.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, [nr.17849/91](#), Aktgjykim i 20 nëntorit 1995, paragrafi 31).
54. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadi në DHPGJS dhe kërkoi që AKP-ja t’ia kompensojë shumën prej 20 përqind nga dëmshpërblimi financiar i caktuar për 18 punëtorët e vdekur, sipas kontratës së përfaqësimit që e kishte lidhur me

ata; dhe kërkoi caktimin e masës së sigurimit ndaj njoftimit të AKP-së, për ta bllokuar shpërndarjen e mjeteve financiare në llogarinë e trashëgimtarëve të punëtorëve të vdekur deri në vendosjen e meritave të kërkesëpadisë.

55. Gjykata thekson se, DHPGJ-ja dhe Kolegji i Apelit nuk vendosën nëse parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në realizimin e 20 përqindëshit nga shuma e përgjithshme e kompensimeve financiare për punëtorët e vdekur, por vendosën vetëm mbi kërkesën për caktimin e masës së sigurimit.
56. Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për pagesën e 20 përqindëshit nga shuma e përgjithshme e kompensimit në rastet e 16 trashëgimtarëve të punëtorëve, Gjykata vlerëson se çështja në fjalë është në procedurë të vendosjes së meritave dhe atëherë do të përcaktohet nëse do t'i njihet e drejta e pronësisë mbi ato mjete parashtruesit të kërkesës apo jo.
57. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e të drejtës për pronë, i përkasin pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara.

### **(3) Në lidhje me pretendimet e tjera**

58. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se aktvendimi i kontestuar ka shkelur nenin 21, 54 dhe 102 të Kushtetutës. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtruesit e kërkesave duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; [KI166/20](#) parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2020, paragrafi 52; [KI04/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
59. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 21, 54 dhe 102 të Kushtetutës, i përkasin pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, dhe rrjedhimisht shpallen si qartazi të pabazuara.

### **(4) Kërkesa për masë të përkohshme**

60. Parashtruesi i kërkesës ka kërkuar nga Gjykata vendosjen e masës së përkohshme ndaj vendimit të Kolegjit të Apelit.
61. Gjykata rithekson se në rastet kur kërkesa shpallet e papranueshme, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet (shih rastet e Gjykatës, [KI19/19](#) dhe [KI20/19](#), parashtrues *Muhamed Thaqi dhe Egzon Keka*, Aktvendim për papranueshmëri, i 26 gushtit 2019, para. 53-55; [KI20/22](#), parashtrues *Gëzim Shtufi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 gushtit 2023, 115-117).
62. Në rastin konkret, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është shpallur e papranueshme dhe rrjedhimisht kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe pikën (a) dhe pikën (b) të paragrafit (2) të rregullit 45 (Vendimmarrja lidhur me kërkesën për masë të përkohshme) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47.1 të Ligjit dhe me rregullin 59 (a) të Rregullores së punës, më 4 shtator 2024, njëzëri

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit;

**Gjyqtari raportues**

  
Safet Hoxha



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**

  
Gresa Caka-Nimani